



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 1108 Prot.

Fier, më 24.01.2025.

PROJEKT VENDIM
Nr. 14, datë 24.01.2025

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Nuri Ferko, lagjia "Mbrogstar Ferko", Njësia Administrative nr.3, i dëmtuar nga zjarri i datës 23.11.2024.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", neni 8 dhe 16 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 23.11.2024, shkresës zyrtare nr.60/1.prot, datë 20.01.2025 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Nuri Ferko dëmi në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **287 550 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë**, dhe në konstruksion banese në vlerën **265 735 (dyqind e gjashhtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 54, shkronja "g",

PROPOZON:

1. Dhënien e ndihmës prej Bashkisë Fier, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **287 550 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë**.
2. Dhënien e ndihmës prej Bashkisë Fier, në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **132 867 (njëqind e tridhjetë e dy mijë tetëqind e gjashhtëdhjetë e shtatë) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës "ç" "Përcaktimi i ndihmës financiare" e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Nuri Ferko është në masën **420 417 (katërqind e njëzetë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 1108 Prot.

Fier, më 24.01.2025.

LËNDA: Relacion për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Nuri Ferko, Lagjia "Mbrostar Ferko", Njësia Administrative nr.3, për dëmet e pësuar në banesën e tij nga zjarri i datës 23.11.2024.

Qëllimi i vlerësimit: Për dhënie ndihme financiare.

1. Bashkia Fier me qëllim dhënien e ndihmës financiare për familjen e dëmtuar të shtetasit Nuri Ferko nxori Urdhërin nr.24, datë 16.01.2025 "**Për ngritjen e Komisionit të Konstatimit të Dëmeve**" për verifikimin e dëmeve, në mbështetje të shkronjës b, pika 1 "**Procedurat e vlerësimit të dëmeve**", paragrafi III i V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "**Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore**".
2. Komisioni i Konstatimit shkoi në banesën e shtetasit Nuri Ferko dhe hartoi Procesverbalin e Konstatimit të dëmeve.
3. Këshilli i Qarkut në zbatim të shkronjës "ç", pika 1 të VKM Nr. 329, datë 16.05.2012, nëpërmjet komisionit të ekspertëve hartoi Preventivën e vlerësimit të dëmeve, në vlerën **287 550 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë** për dëmet e shkaktuara në në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake dhe në vlerën **265 735 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë** për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës.
4. Dhënia e ndihmës prej bashkisë Fier, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në zbatim të detyrimeve të shkronjës "ç", pika 3 "**Përcaktimi i ndihmës financiare**", të VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 jepet në masën **50%**, në vlerën **132 867 (njëqind e tridhjetë e dy mijë tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë**.
5. Vlera financiare e ndihmës që bashkia Fier do të jap për familjen e shtetasit Nuri Ferko do të jetë në masën **420 417 (katërqind e njëzetë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë**.

6. Në zbatim të pikës 2, paragrafi III i VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 u grumbullua i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e ndihmës financiare, si më poshtë:
- a. Kërkesa e shtetasit Nuri Ferko me nr. 12981.prot, datë 10.12.2024
 - b. Vërtetim banimi e Njësisë Administrative nr.3 për shtetasin Nuri Ferko e datës 06.01.2025
 - c. Vërtetim rënie zjarri në banesën e shtetasit Nuri Ferko e lëshuar në datën 25.11.2024 nga Drejtoria e Shërbimit të MZSH-së.
 - d. Çertifikatë familjare e shtetasit Nuri Ferko e lëshuar në datën 25.11.2024.
 - e. Vërtetim që banesa e shtetasit Nuri Ferko është në proces legalizimi me nr.83.prot, datë 08.01.2025.
 - f. Urdhër ngritje Komision Konstatimi me nr.24, datë 16.01.2025.
 - g. Procesverbal Konstatimi me nr.675/1.prot, datë 17.01.2025.
 - h. Preventivë Vlerësim dëmi e Këshillit të Qarkut Fier me nr.60/1.prot, datë 20.01.2025.
 - i. Relacion për dhënie ndihme.
 - j. Projekt Vendim për dhënie ndihme.
7. Bashkia Fier, në zbatim të nenit nr.41 të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 **“Për Mbrojtjen Civile”**, duke u mbështetur në buxhetin e vitit 2025 për Mbrojtjen Civile, për dhënie ndihme financiare familjeve në raste fatkeqësish natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore në bazë të V.K.M.nr.329 datë 16.05.2012, Kreu III, Pika 3, Shkronja d, i propozon Këshillit të Bashkisë dhënien e ndihmës financiare për shtetasin Nuri Ferko në masën 100%, në vlerën **420 417 (katërqind e njëzetë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.**

**DREJTORI I MBROJTJES CIVILE
NASIP BANI**

